

VENDIM
Nr. 499, datë 10.9.2025

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“PËRMIRËSIMI I PRAKTIKAVE TË KONTABILITETIT DHE RAPORTIMIT TË
SEKTORIT PUBLIK NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes së grantit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit “Përmirësimi i praktikave të kontabilitetit dhe raportimit të sektorit publik në Shqipëri”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

XIAOQING YU

Drejtore Rajonale, Ballkani Perëndimor

Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

1 prill 2025

SH. T. Z. Petrit Malaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: Granti nr. TF0C7858

Përmirësimi i Praktikave të Kontabilitetit dhe Raportimit të Sektorit
Publik në Shqipëri
Letërmarrëveshje

Shkëlqesi:

Në përgjigje të kërkesës për ndihmë financiare, të bërë në emër të Republikës së Shqipërisë (“Përfituesi”), kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (“Banka”) që vepron si administratore e Fondit të Besimit për Menaxhimin Financiar me Donator të Vetëm të SECO-s, propozon t’i japë Përfituesit një grant në një shumë që nuk duhet të tejkalojë një milion e dyqind mijë dollarë amerikanë (1,200,000 USD) (“Granti”) sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë letër-marrëveshje (“Marrëveshja”), e cila përfshin aneksin bashkëlidhur, për të asistuar në financimin e Projektit të përshkruar në aneks (“Projekti”).

Ky Grant financohet nga fondi i lartpërmendur i besimit për të cilin Banka merr kontribute periodike nga donatori për fondin e besimit. Në përputhje me seksionin 3.02 të kushteve standarde (siç përcaktohen në aneksin e kësaj Marrëveshjeje), detyrimet e Bankës për kryerjen e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara në shumën e fondeve të vëna në dispozicion të saj nga donatori nën fondin e lartpërmendur të besimit, dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr të ardhurat e Grantit është objekt i disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Përfituesi përfaqëson, duke konfirmuar dakordësinë e tij më poshtë, se është i autorizuar të lidhë këtë Marrëveshje dhe të zbatojë Projektin në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje.

Ju lutem, konfirmoni dakordësinë e Përfituesit për sa më sipër, duke nënshkruar dhe vendosur datën në këtë Marrëveshje nëpërmjet një zyrtari të autorizuar nga Përfituesi dhe kthimin e një kopje të nënshkruar Bankës.

Me respekt,

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

(duke vepruar si administrator i Fondit të Besimit për Menaxhimin Financiar me Donator të Vetëm të SECO-s)

Nga (nënshkrimi)
Xiaoqing Yu
Drejtore Rajonale
Zyra e Bankës Botërore në Vjenë

RËNË DAKORD:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Nga: NËNSHKRIMI
Përfaqësuesi i Autorizuar
Emri: PETRIT MALAJ
Titulli: MINISTRI I FINANCAVE
Data: 29.7.2025
Bashkëlidhur:

1. “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Financimin e Granteve të Ofruara nga Banka nga Fondet e Besimit”, datë 25 shkurt 2019.

2. Letra e disbursimit dhe informacionit financiar të së njëjtës datë me këtë Marrëveshje, së bashku me “Udhëzimet e disbursimit për financimin e projekteve të investimeve”, e shkurtit 2017.

Granti nr. TF0C7858

ANEKS

Neni I

Kushtet standarde; përkufizimet

1.01 **Kushtet standarde.** Kushtet standarde (siç përcaktohen në seksionin 1.02 më poshtë) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

1.02 **Përkufizimet.** Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë dhënë në Kushtet Standarde ose në këtë seksion:

a) “Udhëzime antikorrupsion” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 2 të shtojcës së kushteve standarde, “Udhëzimet për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit në projektet e financuara nga huat e BNRZH-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-s”, të datës 15 tetor 2006 dhe të rishikuara në janar 2011, dhe më 1 korrik 2016.

b) “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin 3.01 të kësaj Marrëveshjeje.

c) “CSAP” ose “Strategji Kombëtare dhe Plan Veprimi” nënkupton planin e veprimit në lidhje me Kontabilitetin e Sektorit Publik, të miratuar nga Përfituesi në vitin 2019, për të shërbyer si udhërrëfyesi kryesor për transformimin e sistemit kombëtar të KSP-së drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara (baza akruale).

d) “Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit” nënkupton strukturën përgjegjëse në MF për harmonizimin e standardeve, rregulloreve dhe procedurave për ekzekutimin, monitorimin dhe raportimin e menaxhimit financiar, kontrollit dhe kontabilitetit në sektorin publik.

e) “Plan i Angazhimit Mjedisor dhe Social” ose “ESCP” nënkupton planin e angazhimit mjedisor dhe social për Projektin, të datës 25 mars 2025, siç mund të ndryshohet herë pas here në përputhje me dispozitat e tij, i cili përcakton masat materiale dhe veprimet që Përfituesi duhet të zbatojë ose do të kërkojë të zbatohen për të trajtuar rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, angazhimet institucionale, të stafit, trajnimit, monitorimit dhe raportimit, si dhe çdo instrument mjedisor dhe social që do të përgatitet më pas.

f) “Standardet mjedisore dhe sociale” ose “ESS” nënkupton të gjitha standardet së bashku si në vijim: (i) “Standardi mjedisor dhe social 1: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale”; (ii) “Standardi mjedisor dhe social 2: Puna dhe kushtet e punës”; (iii) “Standardi mjedisor dhe social 3: Efienca e burimeve dhe parandalimi dhe menaxhimi i ndotjes”;

(iv) “Standardi mjedisor dhe social 4: Shëndeti dhe siguria e komunitetit”; (v) “Standardi mjedisor dhe social 5: Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e detyruar”; (vi) “Standardi mjedisor dhe social 6: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve të gjalla natyrore”; (vii) “Standardi mjedisor dhe social 7: popujt indogjenë/komunitetet lokale tradicionale historikisht të nënshërbyera të Afrikës Nënshahiane”; (viii) “Standardi mjedisor dhe social 8: Trashëgimia kulturore”; (ix) “Standardi mjedisor dhe social 9: Ndërmjetësit financiarë”; (x) “Standardi mjedisor dhe social 10: Angazhimi i palëve të interesuara dhe shpërndarja e informacionit”, në fuqi nga data 1 tetor 2018, sipas publikimit të Bankës.

g) “GDFC” ose “Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve” nënkupton strukturën e MF-së të ngarkuar me aspektet fiduciare për zbatimin e Projektit.

h) “Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit” nënkupton strukturën e MF-së, siç referohet në seksionin 2.03 (a) të këtij aneksi.

i) “MF” nënkupton Ministrinë e Financave të Përfituesit, ose çdo pasues të saj.

j) “Kosto operative” nënkupton shpenzimet e arsyeshme shtesë operative të bëra drejtpërdrejt nga Përfituesi për zbatimin, menaxhimin dhe monitorimin e Projektit, duke përfshirë shpenzimet për komunikimet, shërbimet e përkthimit dhe interpretimit, tarifat bankare, pajisjet e zyrave, reklamat, konferencat, seminarët, shpërndarjen e informacionit lidhur me projektin, qiratë dhe shërbimet utilitare të zyrës, sigurimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve të zyrave, raportimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, udhëtimet, sigurinë, si dhe kosto të tjera të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me Projektin, por duke përjashtuar pagat e nëpunësve civilë të Përfituesit.

k) “MFP” nënkupton menaxhimin e financave publike.

l) “Rregullat e prokurimit” nënkupton, për qëllime të paragrafit 2.0 të shtojcës së kushteve standarde, “Rregullat e prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-së”, shtator 2023.

m) “Ekip i Zbatimit të Projektit” ose “PIT” nënkupton njësinë që do të krijohet nga Përfituesi në përputhje me seksionin 2.03 (a) të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, ose çdo pasues të saj, që konsiderohet i pranueshëm nga Banka, me qëllim ofrimin e mbështetjes dhe koordinimit në menaxhimin e Projektit.

n) “Manual i Operacioneve të Projektit” nënkupton manualin e Përfituesit të pranueshëm nga Banka, të referuar në seksionin 2.03 (d) të aneksit të kësaj Marrëveshjeje, siç ky manual mund të ndryshohet herë pas here me miratimin paraprak të Bankës.

o) “Komitet Drejtues i Projektit” nënkupton komitetin e referuar në seksionin 2.03 (c) të aneksit të kësaj Marrëveshjeje.

p) “KSP” ose “Kontabiliteti i Sektorit Publik” nënkupton sistemin e kontabilitetit të sektorit publik të Përfituesit.

q) “Kushte standarde” nënkupton “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Financimin e Granteve të Ofruara nga Banka nga Fondet e Besimit”, datë 25 shkurt 2019.

r) “Trajnim” nënkupton shpenzimet (përveç atyre për shërbimet e konsulentëve) e kryera për trajnime dhe aktivitete të lidhura me trajnimet në kuadër të Projektit, duke përfshirë shpenzimet për seminare, takime pune dhe vizita studimore, udhëtime, akomodim dhe dieta për pjesëmarrësit në trajnime, pagesa për trajnerët, marrjen me qira të ambienteve të trajnimit, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit, si dhe aktivitete të tjera ndihmëse të lidhura me përgatitjen dhe zbatimin e aktiviteteve të trajnimit.

s) “TVSH” nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni II

Ekzekutimi i Projektit

2.01 Objektivat dhe Përshkrimi i Projektit. Objektivi i Projektit është përmirësimi i praktikave të raportimit financiar dhe kontabilitetit të sektorit publik në qeverisjen qendrore. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve

Mbështetja e stafit të kontabilitetit, financave dhe auditimit të institucioneve të qeverisë qendrore të Përfituesit nëpërmjet ofrimit të aktiviteteve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve, duke u fokusuar në: (a) zhvillimin dhe zbatimin e një programi trajnimi dhe komunikimi bazuar në kërkesat e kuadrit të ri të KSP-së që përfshin politikën, procedurat dhe proceset e KSP-së; (b) forcimin e kapaciteteve teknike të MF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit për zbatimin e Projektit; dhe (c) institucionalizimin e programeve të trajnimit të KSP-së.

Pjesa 2. Zbatimi gradual i Kuadrit të KSP-së në përputhje me SNKSP-në

Ofrimi i mbështetjes për MF-në dhe institucionet e qeverisë qendrore të Përfituesit për zbatimin gradual të Kuadrit të KSP-së, përgatitjen e bilancit të hapjes dhe të pasqyrave financiare të ndërmjetme në përputhje me qëllimin e CSAP-së së rishikuar.

Pjesa 3. Zbatimi i menaxhimit të ndryshimeve dhe menaxhimi i Projektit

Ofrimi i mbështetjes për: (a) zbatimin e menaxhimit të procesit të ndryshimeve nëpërmjet kryerjes së fushatave të informimit dhe komunikimit që synojnë grupe të ndryshme interesi, përfshirë stafet e kontabilitetit, financave, auditimit, deputetë të Kuvendit dhe drejtues të lartë; (b) Ekipin e Zbatimit të Projektit dhe GDFC-në për menaxhimin e Projektit, koordinimin, prokurimin dhe menaxhimin financiar, si dhe monitorimin dhe vlerësimin; dhe (c) Aktivitetet e trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të lidhura me Projektin.

2.02 Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivit të Projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi do të zbatojë Projektin në përputhje me dispozitat e: (a) nenit II të kushteve standarde; (b) udhëzimet antikorruption; dhe (c) këtij neni II.

2.03. Marrëveshje Institucionale dhe të Tjera. Pa kufizime ndaj dispozitave të seksionit 2.02 më sipër:

a) Përfituesi, nëpërmjet MF-së, do të ngrejë dhe më pas do të mbajë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, një ekip të përbërë në çdo kohë nga personel i kualifikuar dhe sipas termave të referencës dhe funksioneve të pranueshme nga Banka, i cili do të jetë përgjegjës për menaxhimin dhe koordinimin e përditshëm të Projektit (“Ekipi i Zbatimit të Projektit” ose “EZP”). Për këtë qëllim: (i) EZP do të përbëhet, ndër të tjera, nga zyrtarë të Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe njësi të tjera të lidhura me menaxhimin e reformës së MFP-së dhe projektet e financuara nga donatorët; dhe (ii) Përfituesi do të punësojë, jo më vonë se 1 (një) muaj pas datës së hyrjes në Fuqi, një ekspert lokal si pikë fokale për çështje mjedisore dhe sociale, me kualifikimet e duhura dhe sipas kushteve të referencës të pranueshme për Bankën, për të mbështetur Ekipin e Zbatimit të Projektit.

b) Përfituesi, nëpërmjet MF-së, do të garantojë që GDFC-ja të jetë struktura përgjegjëse për aspektet fiduciare të zbatimit të Projektit, duke përfshirë menaxhimin financiar dhe prokurimin.

c) Përfituesi, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të Projektit, do të ketë një Komitet Drejtues të Projektit i cili do të jetë përgjegjës për: (i) mbikëqyrjen e zbatimit të Projektit; (ii) ofrimin e udhëzimeve të politikave; (iii) monitorimin e progresit; dhe (iv) sigurimin e koordinimit të palëve të interesuara.

d) Përfituesi, nëpërmjet MF-së, do të zbatojë Projektin në përputhje me Manualin e Operacioneve të Projektit, duke përfshirë, *ndër të tjera*: (i) marrëveshjen për menaxhimin financiar dhe disbursimin sipas Projektit; (ii) procedurat e prokurimit, dokumentacionin standard të prokurimit dhe procedurat e administrimit dhe menaxhimit të kontakteve; (iii) administrimin institucional, koordinimin dhe zbatimin e përditshëm të Projektit; (iv) monitorimin dhe vlerësimin; (v) raportimin; (vi) aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve, duke përfshirë trajnimin; dhe (vii) masa dhe procedura të tjera teknike dhe organizative që do të kërkohen për Projektin.

e) Përfituesi nuk do të caktojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë ose lejojë që të caktohet, ndryshohet, shfuqizohet ose hiqet dorë nga Manuali i Operacioneve të Projektit ose ndonjë dispozitë e tij, në një mënyrë që, sipas opinionit të Bankës, mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në zbatimin e Projektit.

2.04 Standardet mjedisore dhe sociale

a) Përfituesi do të garantojë që Projekti të zbatohet në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

b) Pa kufizim në paragrafin “a” më sipër, Përfituesi do të garantojë që Projekti të zbatohet në përputhje me Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social (“ESCP”), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Përfituesi duhet të garantojë që:

i. masat dhe veprimet e specifikuar në ESCP të zbatohen me kujdesin e duhur dhe në mënyrë efektive, siç parashikohet në ESCP;

ii. të ketë në dispozicion fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të ESCP-së;

iii. të ketë politika dhe procedura dhe numër të mjaftueshëm të personelit të kualifikuar dhe me përvojë për të zbatuar ESCP-në, siç parashikohet në ESCP; dhe

iv. të mos ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet dorë nga ESCP-ja ose ndonjë dispozitë e tij, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç specifikohet në ESCP, dhe të sigurojë publikimin e menjëhershëm të ESCP-së së rishikuar.

c) Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet ESCP-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

d) Përfituesi do të garantojë që:

i. të merren të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur, hartuar dhe vënë në dispozicion të Bankës, nëpërmjet raporteve të rregullta, sipas periodicitetit të specifikuar në ESCP, dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta, nëse kjo kërkohet nga Banka, informacion mbi statusin e përputhshmërisë me ESCP-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të, ku të gjitha këto raporte në formë dhe përmbajtje të jenë të pranueshme për Bankën, duke përcaktuar, ndër të tjera: (A) statusin e zbatimit të ESCP-së; (B) kushtet, nëse ka, që ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e ESCP-së; dhe (C) masat korrigjuese dhe parandaluese që merren ose që duhet të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

ii. Banka të njoftohet menjëherë për çdo incident ose aksident që lidhet ose ka ndikim në Projekt, i cili ka ose mund të ketë ndikim negativ të konsiderueshëm në mjedis, komunitetet e prekura, për publikun ose punëtorët, në përputhje me ESCP-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në të dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

f) Përfituesi do të krijojë, publikojë, mirëmbajë dhe operojë një mekanizëm të aksesueshëm për ankesat, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të personave të prekur nga Projekti, dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të zgjidhu ose lehtësuar zgjidhjen e këtyre shqetësimeve dhe ankesave, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2.05 Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i Projektit. Përfituesi do të garantojë që raportet e Projektit t'i dërgohen Bankës jo më vonë se 45 (dyzet e pesë) ditë pas çdo gjashtëmujori kalendarik, ku raportet mbulojnë periudhën gjashtëmujore kalendarike.

Neni III

Tërheqja e të ardhurave nga granti

3.01 Shpenzimet e pranueshme. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit në përputhje me dispozitat e: (a) nenit III të Kushteve Standarde; dhe (b) këtij seksioni; për të financuar shpenzimet e pranueshme në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e përcaktuar për secilën kategori sipas tabelës së mëposhtme.

Kategoria	Shuma e grantit të alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat, përveç TVSH-së)
(1) Mallra, Shërbime Konsulence dhe Jo-konsulence, Kosto Operative dhe Trajnime në kuadër të Projektit	1,200,000	100%
SHUMA TOTALE	1,200,000	

3.02 Kushtet e tërheqjes. Pavarësisht dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesat e kryera para datës së kësaj Marrëveshjeje.

3.03 *Periudha e tërheqjes*. Afati i fundit është data 30 qershor 2028.

Neni IV

Hyrja në fuqi; përfundimi

4.01 Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi derisa Banka të ketë siguruar dëshmi të pranueshme për Bankën, specifikisht që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Përfituesit janë autorizuar siç duhet nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

4.02 Si pjesë e provave që duhet të jepen në përputhje me seksionin 4.01, Bankës do t'i jepet një opinion ose opinione të pranueshme për Bankën nga këshilltarë ligjorë të pranueshëm për Bankën ose, nëse Banka e kërkon këtë, një certifikatë të pranueshme për Bankën nga një zyrtar kompetent i Vendit Anëtar, që tregon, në emër të Përfituesit, se kjo Marrëveshje është autorizuar ose ratifikuar në mënyrë të rregullt nga Përfituesi, dhe dorëzuar dhe dërguar në emër të tij dhe është ligjshme dhe detyrueshme për të në përputhje me kushtet e tij.

4.03 Përveç rasteve kur Përfituesi dhe Banka bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Banka i dërgon Përfituesit njoftimin për pranimin e provave të kërkuara sipas seksionit 4.01 ("Data e hyrjes në fuqi"). Nëse, përpara datës së hyrjes në fuqi, ka ndodhur ndonjë rast që do t'i jepte Bankës të drejtën të pezullonte të drejtën e Përfituesit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Grantit nëse kjo Marrëveshje do të kishte hyrë në fuqi, Banka mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të përmendur në këtë seksion derisa një rast (ose rastet) të ketë pushuar (ose të kenë pushuar) së ekzistuari.

4.04 *Përfundimi për shkak të moshyrjes në fuqi*. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj, do të përfundojnë nëse ajo nuk ka hyrë në fuqi deri 90 ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse Banka, pas shqyrtimit të arsyeve të vonësës, cakton një datë të mëvonshme për qëllimin e këtij seksioni. Banka do të njoftojë menjëherë Përfituesin për këtë datë të mëvonshme.

Neni V

Përfaqësuesi i përfituesit; adresat

5.01 *Përfaqësuesi i Përfituesit*. Përfaqësuesi i Përfituesit, i referuar në seksionin 7.02 të kushteve standarde, është ministri i Financave dhe Ekonomisë.

5.02 *Adresa e Përfituesit*. Për qëllimet e seksionit 7.01 të kushteve standarde:

a) Adresa e Përfituesit është:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3

Tiranë, Shqipëri; dhe

b) Adresa elektronike e Përfituesit është:

E-mail:

sekretariamin@financa.gov.al

5.03 *Adresa e Bankës*. Për qëllimet e seksionit 7.01 të kushteve standarde:

a) Adresa e Bankës është:

International Bank for Reconstruction and Development

International Development Association

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433 United States of America; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks:

248423 (MCI) ose

64145 (MCI)

Faks:

1-202-477-6391

